



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 24, 30, d 31 tetor dhe 5 nëntor 2018.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor” (*Komision për dhënie mendimi*)
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë” (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Edmond Panariti dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Artemis Dralo – Zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme

Illir Melo - Drejtor i Rajonit dhe Vendeve Fqinje në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Armand Skapi - Drejtor ne Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme:

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrera – Drejtore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Albana Fico - Drejtore e Institutit te Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Genc Byrazeri - Nëndrejtor i Institutit të Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës. Sot do të shqyrtojmë tri çështje. Fillojmë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 24, 30 dhe 31 tetor, si dhe 5 nëntor 2018.

A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratoohen procesverbalet e mbledhjeve të komisionit për datat 24, 30, 31 tetor dhe 5 nëntor 2018.

Çështja e dytë që kemi në rendin e ditës është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”. Sa i takon këtij projektligji komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe relatore e këtij projektligji është kolegja Elena Xhina.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme zonja Artemis Dralo, zëvendësministre, zoti Ilir Melo, drejtor i Rajonit dhe i Vendeve Fqinje dhe zoti Armand Skapi, drejtor në Drejtorinë e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane.

Zonja Dralo, mirë se keni ardhur në komision së bashku me stafin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme!

Do t’ju lutesha shkurtimisht të na bënit një prezantim të shkurtër të këtij projektligji për kolegët deputetë, por edhe për opinionin publik dhe më pas fjalën e ka relator zonja Xhina.

Fjala për ju.

**Artemis Dralo** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor “RYCO”, e cila është nënshkruar më 28 gusht të këtij viti, është e bazuar në statusin e zyrës rajonale për bashkëpunim rinor, e cila konsiderohet si pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje për ngritjen e po kësaj zyre. Marrëveshja ka si synim rregullat e funksionimit të RYCO -s, statusin ligjor, si dhe privilegjet dhe imunitetet e stafit që do të ushtrorë aktivitetin në

këtë strukturë. Stafi do të përbëhet prej 13 vetash dhe vetëm 2 prej tyre janë diplomatë. Kjo marrëveshje kryesisht i hap rrugë jo vetëm funksionimit të këtij mekanizmi, por qëllimi kryesor është realizimi i financimit të projekteve, por edhe forcimi i stabilitetit dhe i progresit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon t'i hapë rrugë formalizimit të RYCO -s, e cila përbën një hap shumë të rëndësishëm në vizionin e Shqipërisë dhe është një frymëzim në rajon, por veçanërisht synon rininë. Pranimi nga vendet e Ballkanit Perëndimor që RYCO, ashtu si më herët, është kryer edhe për një marrëveshje paraprake të Fondit të Ballkanit Perëndimor, pra është e dyta marrëveshje që ratifikohet, tashmë është pranuar dhe kanë filluar projektet. Selitë e tyre janë vendosur në Tiranë dhe kjo është një indicie, e cila do të shërbejë për përshejtimin e bashkëpunimit rajonal për gjithë rajonin.

Sipas kësaj marrëveshjeje, duke qenë se është themeluar si një organizatë ndërkombëtare, RYCO do të gëzojë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji shqiptar dhe do të ketë kapacitetin ligjor të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tij. Për të përmbushur aktivitetet e kësaj organizate nëpërmjet kësaj marrëveshjeje vendi pritës siguron paprekshmërinë e godinës së RYCO-s, dokumentet, materialet arkivore dhe çfarëdolloj pajisje kompjuterike që i përkasin dhe janë në pronësi të RYCO-s. Marrëveshja kryesisht parashikon përjashtimin nga taksat për përdorim të fondit të tij në të njëjtat kushte, siç është parashikuar për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri.

Në zbatim të neneve 121 dhe 155 të Kushtetutës marrëveshja e vendit pritës duhet t'i nënshtrohet procesit të ratifikimit, pasi ka të bëjë me përjashtimin ose më saktë me lehtësimin nga taksat. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje nuk sjell asnjë efekt nga pikëpamja buxhetore. Pra, ne jemi të privilegjuar, sepse jemi në rastin e fitimit të munguar në kushtet kur ambienti i ofruar për këtë seli është pa pagesë, është pronë e shtetit shqiptar dhe administrohet nga Drejtoria e Trupit Diplomatik. Gjithashtu, nuk do të vilen ato tatime dhe taksa për të cilat RYCO dhe stafi ndërkombëtar janë të përjashtuar. Pra, me pak fjalë, miratimi i këtij ligji sjell efekte financiare për buxhetin e shtetit në një vit. Shuma e TVSH-së që mund të kërkohet për rimbursime është përafërsisht rreth 46,576 euro.

Shkurtimisht këto janë qëllimet kryesore dhe përfitimet që kemi nga kjo marrëveshje.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Dralo!

Fjalën e ka zonja Xhina si relatores e këtij projektligji.

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zëvendësministren për parashtrimin e projektligjit!

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje ndihmon në zbatimin e marrëveshjes ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor. Kjo zyrë është një mekanizëm institucional rajonal me mandat dhe kapacitet për të krijuar kushtet për të mbështetur aktivitetet që nxisin vlerat demokratike, pjesëmarrjen, qytetarinë aktive dhe të mësuarit ndërkulturor, përmes krijimit të mundësive që të rinjtë të takohen, të njihen, të krijojnë shoqëri dhe të angazhohen në dialog rajonal në çështje që do t'i mbështesin ata për të krijuar një të ardhme më të mirë për të gjithë. Krijimi i kësaj zyre, sidomos vendosja e selisë së saj në Tiranë, do të shërbejë si instrument për përshpejtimin e bashkëpunimit rajonal jo vetëm rinor, por edhe më gjerë.

Në këto kushte, në aspektin ligjor, duke qenë se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe është paraqitur sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit, u propozoj kolegëve miratimin e tij.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Xhina!

A ka pyetje nga kolegët lidhur me projektligjin?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Kam dy pyetje, jo një. Një pyetje do ta bëj për ministrin, drejtorët ta mbajnë shënim.

Zoti kryetar, në relacion thuhet se krijimi i Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor me seli në Tiranë tregon qartë vullnetin e qeverisë shqiptare, madje vizionin e ri të Shqipërisë për rajonin. Kjo nismë do të shërbejë si instrument për përshpejtimin e bashkëpunimit rajonal jo vetëm rinor, por edhe më gjerë. Unë dua të di se çfarë pasqyrohet me termin “më gjerë”, ndërkohë që është ajo është një zyrë për rininë? E para.

E dyta. Në nenet 7 dhe 8 thuhet: “Parashikohet përjashtimi për taksat, kjo më intereson më shumë...”

**Ulsi Manja** – E dija këtë gjë që kur e kërkove fjalën për të bërë pyetje.

**Bashkim Fino** - ... për ZRBB-në dhe përdorimin e fondit të tij në të njëjtat kushte që parashikohet e të tjera...” Duke e krahasuar këtë pjesë të relacionit me nenin 7 të marrëveshjes, pasi në nenin 7, pika 2, është një pjesë shumë interesante, të cilën po jua lexoj: “Përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar, TVSH-je, i përfshirë në çmimet apo faturat më vete do të aplikojnë

vetëm mbi një sasi të arsyeshme të artikujve, shërbime të blera për përdorim zyrtar nga sekretariati”. Këtë gjë Adnori, në fakt, nuk e kupton, por unë po e lexoj që ta kuptoj edhe ai...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Pra, në të thuhet: “Në këtë rast mallrat e blera për përdorim nga sekretariati, për të cilat aplikohen përjashtim, sipas kësaj dispozite nuk mund të shiten, të dhurohen apo të asgjësohen në asnjë mënyrë përveç kushteve të rëna dakord nga qeveria e vendit pritës”. Çfarë bëhet me gjithë këto pajisje? Pra, të gjitha këto pajisje as shiten, as dhurohen, por vetëm kur është rënë dakord me qeverinë e vendit pritës. Çfarë do të bëhet me këto, sepse për t’u asgjësuar nuk asgjësohen, për t’u shitur nuk shiten, atëherë do të kthehen prapë në origjinë ku janë blerë? Pra, duhet parë nenet 7 dhe 8 që flasin për taksën dhe pika 2 e nenit 7.

Këto dy pyetje janë më shumë sqaruese, sepse nuk shoh as se kush e ka firmosur këtë marrëveshje, pasi marrëveshja nuk ka firmë, por gjithsesi po e quaj sikur e kanë firmosur. A e ka firmosur njeri këtë, apo jo?

*(Diskutime pa mikrofon)*

Unë e kam pa firmë, ndoshta ma kanë dhënë mua pa firmë. E kanë vënë kastile të më provokojnë mua që t’ju pyes juve.

Urdhëroni!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – A kanë përfaqësuesit e ministrisë ndonjë shpjegim lidhur me nenin 7, pika 2.

**Artemis Dralo** – Sa i takon pjesës së parë, projektet që përfshihen në këtë marrëveshje sigurisht që kanë në fokus rininë, por kur themi “dhe më tej”, nënkuptojmë që kanë përfitime në një *background* më të gjerë social për të gjitha shtresat e shoqërisë.

Sa i takon pyetjes së dytë, për pjesën ekonomike...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Projektet, të cilat janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, sigurisht që janë të fokusuara te rinia dhe më gjerë në rajon, jo vetëm në Shqipëri, sepse është ballkanike, por përfitojnë më gjerë edhe shtresat sociale, jo vetëm rinia.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, pak qetësi!

Fjalën e ka zoti Skapi, për të na dhënë një shpjegim për pyetjen që ngriti zoti Fino, lidhur me nenit 7 të marrëveshjes,

**Armand Skapi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sqarimi im për pikën 2 lidhet me faktin që kjo dispozitë sanksionon detyrimin që ka zyra e RYCO-s për të përdorur vetëm për qëllime zyrtare të gjitha produktet, shërbimet që ajo merr pa TVSH, me synimin për të parandaluar çfarëdolloj abuzimi që mund të bëjë kjo zyrë, teorikisht, hipotetikisht, për t'i rishitur apo për të transferuar destinacionin e këtyre produkteve. Pra, ky është synimi për të shmangur çfarëdolloj abuzimi me përfitime nga shmangia e taksave dhe tatimet..

**Bashkim Fino** – Çfarë bëhet me këto produkte?

**Armand Skapi** - Përdoren nga zyra...

**Bashkim Fino** – Ju keni shkruar këtu: “Nuk shiten, nuk dhurohen apo asgjësohen”. Pra, çfarë bëhet me këto produkte në fund? Unë mendoj se duhet t'i lësh një shteg vetes tënde se çfarë bëhet me këto produkte, do t'i mbyllësh në një zyrë...

**Armand Skapi** – Këto produkte janë vetëm për përdorim zyrtar. Pra, do të blihet letër apo do të blihet një shërbim le të themi, atëherë këto nuk shkojnë në ndonjë destinacion tjetër përveçse për përdorimin e zyrës dhe ky është synimi i dispozitës.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka diskutime? Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Po, kam diskutim. Unë jam plotësisht dakord me projektligjin dhe ne duhet ta miratojmë. Është fat i madh për gjithë rajonin që kjo zyrë vendoset në Shqipëri dhe kjo është diçka mjaft pozitive. Gjithsesi, vërejtja që unë kam për shkak edhe të pyetjeve që bëra, është se ne duhet të jemi të kujdesshëm kur bëjmë marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe, sepse marrëveshjet duhet të jenë në funksion me ligjet e shtetit shqiptar, të ndërthurura me to dhe të mos ketë përplasje. Një formulim i tillë te neni 7, mua më duket i papranueshëm, sepse nuk mund të jesh kaq herezit, sepse as shiten, as blihen, as asgjësohen e të tjera. Unë mendoj se zyrës përkatëse i duhet lënë hapësirë, pa dashur, siç e tha edhe drejtori që gjërat të tjetërsohen, pra ato gjëra që jepen për atë zyrë duhet të jenë në funksion të asaj zyre dhe për këtë nuk jam kundër, por duhet të jemi të kujdesshëm kur formulojmë dhe bëjmë marrëveshje të tilla, sepse marrëveshjet për fatin e

keq të ministrive, kur vijnë në parlament, studiohen nga ana jonë, prandaj duhen parë sa më mirë nga zyrat që i formulojnë ato.

Sa i takon nenit 7, pika 2, mendoj se mënyra se si është shkruar është e papranueshme, sepse t'i lidh duart për çdo gjë. Pra, sipas këtij nenit gjërat as shiten, as blihen, as dhurohet, as asgjësohen, i ka të gjitha në mënyrë absolute...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Më fal, të mbaroj fjalën!

Pra, me atë që është shkruar këtu i keni lidhur duart çdo gjëje, nuk mund të bësh dot asgjë, nuk blihet, nuk shiten, nuk dhurohet, nuk asgjësohet. Pra, ka futur edhe asgjësimin, sepse po ta kishte harruar këtë të fundit, mund të ishte pak e pranueshme. Mënyra se si është formuluar mua nuk më duket normale, por nuk kemi se çfarë t'i bëjmë, sepse këta e kanë firmosur, por u tërheq vëmendjen, që marrëveshjet e tjera t'i bëjnë më mirë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

A ka diskutime të tjera?

Po, zonja Hysi.

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam pasur mundësi ta ndjek diskutimin e kësaj projekt marrëveshjeje edhe në Komisionin për Politikën e Jashtme. E vlerësoj faktin që ka një marrëveshje, e cila synon t'i përafrojë vendet nëpërmjet rinisë. Duke lexuar nenin 8 të marrëveshjes më bie në sy mënyra e përdorimit të fondeve. Nuk e di nëse kjo është një mënyrë standarde në të gjitha marrëveshjet ku ne jemi një vend pritës. Po jua lexoj, të nderuar kolegë, pjesën ku thuhet: “Zyra ka të drejtë të marrë, të mbajë, të shkëmbejë, të transferojë të gjitha fondet, monedha dhe paratë kesh dhe t'i përdorë lirshëm dhe në përputhje me rregullat e vendit pritës në të njëjtat kushte si misionet e tjera diplomatike”. A ka ndonjë problem që të kesh para, të zbatosh procedurën në doganë? Kur ke mbi 10 mijë euro duhet t'i deklarosh, kur ke nën 10 mijë nuk është e nevojshme? Pse duhet vënë kjo në marrëveshje?

Gjithashtu, shoh që në këtë marrëveshje i është dhënë shumë rëndësi ngritjes së zyrës se sa aktivitetit dhe fushës së veprimtimit të zyrës. Nëse ne nuk do t'i kishim sqarimet tuaja, askush nuk mund ta kuptonte nga marrëveshja se cili është qëllimi i zyrës, misioni, aktivitetet dhe impakti që do ketë. E vetmja gjë që mësojmë është se qeveria shqiptare do të paguajë paratë për zyrën dhe



asgjë tjetër. Në këtë kuadër, duke qenë se zoti Skapi, i cili ka një përvojë të gjatë sa u takon marrëveshjeve, mendoj se do të ishte mirë, ndoshta mund të jem e gabuar, por të kishte diçka më shumë për qëllimin dhe objektin e kësaj marrëveshjeje do të ishte e rekomandueshme.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zoti Skapi, diçka për përdorimin e fondeve në lidhje me shqetësimin që ngriti zonja Hysi.

**Armand Skapi** – Faleminderit për pyetjet!

Në lidhje me çështjen e nenit 8...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem, një përgjigje të shkurtër...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Shqetësimi që ngriti zonja Hysi, është i rëndësishëm, prandaj dua një përgjigje nga përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme.

**Armand Skapi** – Në lidhje me pyetjen e parë për nenin 8, kjo është një dispozitë standarde që aplikohet në çfarëdolloj marrëveshjeje selie që lidhet me dhënien e imunitetit dhe privilegjet për zyrat apo selitë e organizatave ndërkombëtare, e cila është rrjedhojë e Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike. Pra, zyrës do t'i njihet i njëjti status që u njihet të gjithë përfaqësive diplomatike në Republikën e Shqipërisë. Të njëjtën dispozitë pak a shumë e ka edhe marrëveshja e selisë për Zyrën Fondit të Ballkanit Perëndimor, që kaloi para disa kohësh në komisione dhe në parlament.

Sa i takon pyetjes së dytë, ju sqaroj se kjo marrëveshje ka si synim vetëm rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit shqiptar dhe zyrës, nëpërmjet ofrimit të imuniteteve, privilegjeve dhe lehtësirave për ushtrimin normal të funksioneve të kësaj zyre. Sa i përket aktivitetit të zyrës është marrëveshja bazë për krijimin e Zyrës RYCO, e cila kaloi vjet në parlament dhe u ratifikua, kështu që aty janë të përcaktuara të gjitha qëllimet, synimet që duan të realizojnë palët nëpërmjet marrëveshjes themeluese të RYCO-s.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Skapi!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Bashkim, nëse ju keni kohë të mjaftueshme në dispozicion, i diskutojmë gjerë e gjatë projekt marrëveshjet. Mund ta marrësh fjalën prapë për diskutim.

**Bashkim Fino** – Sa i takon nenit 8, që flet për çështje fondesh, siç u shpreh edhe zonja Hysi, mund të kalojnë dhe transferohen pa problem nga një shtet në shtetin tjetër. Ndërsa, sa i takon nenit 7, të cilin e lexova unë, për pajisjet e zyrës, që as shiten, as blihen dhe as asgjësohen, nuk mund të bëhet asnjë gjë. Pra, nëse do t'i shpien bazë materiale, ai thotë jo, ndërkohë që paratë mund t'ia dërgosh...

**Ulsi Manja** – Ti ke të drejtën tënde ta diskutosh gjerë e gjatë, por zonja Hysi, problemet që ngriti këtu duhej t'i kishte ngritur te Komisioni i Jashtëm, sepse është komisioni përgjegjës.

Ti si anëtar i Komisionit të Ligjeve ke të drejtën tënde që të kërkosh shpjegime nga fillimi në fund, por zonja Hysi, te Komisioni i Jashtëm ka pasur...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Liria e fjalës vetëm në komisionin tonë është, sepse edhe debati është edhe më i këndshëm.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor”.

Ky projektligj së bashku me relacionin përkatës t'i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare për votim.

Këtu mbyllet çështja e dytë e rendit të ditës.

Faleminderit zonja Dralo, zoti Melo, zoti Skapi për prezentën tuaj në komision!

Ditë të mbarë!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.11.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë” (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia, Arben Pëllumbi.

#### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Edmond Panariti dhe Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Antoneta Njehrrëna – Drejtore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Albana Fico - Drejtore e Institutit të Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Genc Byrazeri - Nëndrejtor i Institutit të Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Alban Ylli - Shef Departamenti, Instituti i Shëndetit Publik

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me çështjen e fundit që kemi në rendin e ditës, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”. Edhe për këtë projektligj komisionin ynë është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është zoti Adnor Shameti. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale zonja Mira Rakacolli,

zëvendësministre, zonja Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë dhe zoti Genc Byazeri, nëndrejtor i Institutit të Shëndetit Publik.

Mirë se keni ardhur në komision, zonja zëvendësministre!

Do t’ju lutesha shumë shkurt për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik, të na shpjegoni se çfarë përmban kjo marrëveshje. Fjala është për ju!

**Mira Rakaçolli** – Faleminderit!

Projektligji, për të cilin po kërkojmë miratimin e këtij komisioni, i hap rrugë përfundimit të një studimi shumë të gjerë shëndetësor demografik, jep të dhëna të domosdoshme për gjendjen shëndetësore për të përcaktuar politikën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Konkretisht, merr në konsideratë gjendjen shëndetësore të popullsisë nga mosha 0 deri në 60 vjeç, duke u marrë me tregues të tillë, si: lindshmëria, vdekshmëria, gjendja ekonomike-shoqërore, niveli i edukimit shëndetësor, niveli i edukimit në përgjithësi, pra të dhëna të cilat bëjnë që ne të shohim përtej numrave dhe të analizojmë përse i kemi ata tregues dhe të marrim masa jo vetëm si ministri, por ndoshta edhe ministrinë e tjera, për të përcaktuar politikën shëndetësore dhe ato sociale.

Doja të nënvizoja që është një studim, i cili para 10 vjetësh është bërë në një masë shumë më të vogël dhe kanë qenë pikërisht të dhënat që kanë shërbyer si bazë e strategjisë sonë kombëtare të shëndetësisë dhe programeve të rëndësishme të Ministrisë së Shëndetësisë, siç janë: programi që ka të bëjë me sëmundjet e transmetueshme, me sëmundjet infektive apo me shëndetin riprodhues. Ka një metodologji bashkëkohore dhe, për shkak të rëndësisë që ka ky studim për përcaktimin e politikave dhe për krahasimin e Shqipërisë me vendet e rajonit, është mbështetur fuqimisht, financiarisht edhe nga qeveria zvicerane dhe nga organizmat e Kombeve të Bashkuara. Financimin kryesor për këtë projekt e ka dhënë qeveria zvicerane me një fond prej 800 mijë

frangash zvicerane. Kanë kontribuar organizmat e *United Nations* me një vlerë prej 150 mijë dollarësh, por që të përfundojë si duhet ky studim, për shkak të disa ndryshimeve në kursin e monedhave, edhe për shkak të disa të dhënave shtesë që u kërkuan të merren kur u pa sa i rëndësishëm është, ka dalë nevoja e një financimi tjetër prej rreth 300 mijë dollarësh, nga të cilat 100 mijë do t'i paguajë UNFPA-ja, ndërsa 200 mijë do t'i paguajë Ministria e Shëndetësisë pa dalë nga buxheti, pra pa kërkuar një buxhet plus mbi atë buxhet, i cili na është akorduar nga Këshilli i Ministrave.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që ka ky studim për përcaktimin e politikave më të drejta shëndetësore dhe sociale, do të kërkoja miratimin e këtij komisioni për ta çuar më tutje atë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Rakaçolli!

Zoti Shameti, fjala për ju lidhur me këtë marrëveshje.

**Adnor Shameti** – Faleminderit, zoti kryetar!

Sot para këtij komisioni është paraqitur projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”.

Zëvendësministrja e Shëndetësisë ka qenë shteruese në informacionin e paraqitur para këtij komisioni. Në këto kushte nuk më mbetet gjë tjetër veçse të ftoj të gjithë anëtarët e komisionit ta votojmë njëzëri.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – A është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren projektligji?

**Adnor Shameti** – Sikurse jua kam paraqitur edhe në relacion, projektligji është në përputhje të plotë edhe me Kushtetutën, edhe me Rregulloren e Kuvendit.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Shameti!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Projektligji është shumë interesant. Për këtë studim demografik për politikën tona nga 0-60 vjeç nuk mjaftonin 800 mijë franga zvicerane, që kur është bërë në fillim, por kërkohen edhe 300 mijë dollarë të tjerë. Zëvendësministrja na tha se 200 mijë janë pjesë e buxhetit dhe i disponon vetë Ministria e Shëndetësisë. Në relacionin e paraqitur, zoti kryetar,

thuhet: “Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen e zbatimit të këtij projektligji”. Pyetja është: pse duhet të jetë Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatim kur fondet janë të ezauruara në buxhet e me radhë? Në qoftë se Ministria e Financave ua ka dhënë këtë fond dhe janë brenda buxhetit...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ua ka dhënë, se kështu tha zëvendësministrja! 800 mijë franga i ka dhënë qeveria zvicerane, 200 mijë i ka vet ministria, pra, në këtë rast nuk kemi pse themi se për zbatimin e kësaj duhet të ngarkohet Ministria e Financave. Çfarë do të thotë kjo, që, nëse do të duhen fonde të tjera shtesë, do t’i japë Ministria e Financave?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Unë kam të drejtë ta pyes. Ndoshta është një pakënaqësi nga ana ime, por jam brenda të drejtës sime të bëj një pyetje të tillë, sepse relacioni nuk përputhet me atë që ka thënë zëvendësministrja. Jam dakord me projektligjin, por, në fund të fundit, pse duhet të ngarkojmë Ministrinë e Financave kur nuk kemi probleme?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

A ka një përgjigje nga përfaqësuesja e Ministrisë së Shëndetësisë?

**Mira Rakaçolli** – Ndoshta nuk u shpreha siç duhet! Ne nuk do të kërkojmë buxhet tjetër, por do të rialokojmë fondet që kemi brenda ministrisë në këtë studim.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

Ka pyetje të tjera? Zonja Hysi, fjala për ju.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, doktoreshë, për prezantimin dhe për nismën!

Kam dy pyetje që lidhen me marrëveshjen në tërësi dhe me relacionin e këtij projektligji: ju thatë se ky nuk është studimi i parë, por ka pasur edhe studime të tjera, të cilat kanë qenë më të vogla. A ka kapacitete INSTAT-i, Instituti i Shëndetit Publik dhe vetë ministria që në të ardhmen të bëjë studime të tilla demografike më sistematike pa qenë nevoja që gjithë kohës të kemi gjithë angazhimin vetëm të ndërkombëtarëve, se shikoj që pjesa më e madhe e punës dhe e fondeve shkon për ekspertizën e huaj?

Së dyti, kemi diskutuar prej kohësh dhe unë do të përfitoj nga rasti, meqenëse keni përvojën e mjekut dhe tani në pozicionin e zëvendësministres, shoqëroheni nga një staf jetëgjatë në atë ministri, që relacionet duhet të përmbajnë më tepër informacion lidhur me përfundimet dhe rezultatet se sa do të ndikojnë këto studime në kategoritë që përmendni në relacion, konkretisht në faqen 1 dhe 2. A keni një studim apo tregues se cili do të jetë përfitimi jo vetëm i ministrisë suaj, por, sipas kategorive që ju përmendni: fëmijët 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, gratë e moshës riprodhuese, individët e kështu me radhë, pra për të matur efektivitetin e gjithë këtij shpenzimi, fondi, që është relativisht shumë i lartë, 220 milionë lekë të vjetra, pa folur për të gjitha donacionet e tjera? Po impakti ka ndonjë tregues se sa për qind do të ulët vdekshmëria, sa për qind do të informohet etj.? Këtë e kemi edhe në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Ka disa indikatorë, të cilët duhet t'i vlerësojmë se sa efektivitet do të ketë ky studim, por nuk mund ta bëjmë pa pasur këto të dhëna në relacion.

Faleminderit!

**Mira Rakaçolli** – Ky është studimi i dytë që vlerëson këta tregues, i cili është bërë në një kampion njerëzish shumë më të madh sesa studimi i parë. Të dhënat e studimit të parë i kanë shërbyer Ministrisë së Shëndetësisë për të bërë politikat që përmenda, sociale dhe programet e mëdha. Studimi i dytë i bërë në një kampion edhe më të madh shërben më tepër për të treguar efikasitetin e këtyre politikave. Faktikisht, me të dhënat paraprake që kemi marrë nga ky studim, kemi parë se zhvillimi i fëmijëve 0-5 vjeç përpara 10 vjetësh ka qenë mjaft më i ulët se mesatarja europiane, ndërsa në këtë studim është parë se, me siguri si rezultat i politikave që janë bërë, ky zhvillim ka dalë afër normave europiane. Pra, këto tregojnë sesi duhet t'i përshtatim politikat, nëse të dhënat nuk na dalin siç duhet.

Po kështu, krahasuese kanë qenë edhe të dhënat që kemi marrë për sëmundjet infektive, për jetëgjatësinë, për mortalitetin infantil, sidomos për mortalitetin amëtar.

Lidhur me pyetjen tuaj të parë, se ndoshta kalova tek e dyta, këto studime që financohen nga të huajt, bëhet ekspertiza e tyre, por personat që i bëjnë janë shqiptarë

të përfshirë nga institucionet tona të shëndetit publik, të cilët trajnohen dhe mbeten. Pra, janë një aset që na mbetet për të vazhduar dhe për t'i aktivizuar edhe në projekte të ngjashme me këtë dhe në projektet që ndoshta do të zhvillohen në vitet e ardhshme. Kështu që mendoj se bërja e këtyre studimeve nuk është thjesht në dhënien e rezultateve, por edhe në edukimin që i bëhet



personelit për t'u marrë me këto studime, sepse në eksperiencat e mëparshme, po flas për 2-3 dekada më parë, nuk janë mësuar nëpër shkolla dhe nuk kanë qenë të zakonshme për Shqipërinë.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka!

Kalojmë në votimin në parim të kësaj projekt marrëveshjeje.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë” ? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Edhe ky projektligj, së bashku me relacionin përkatës t'i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare për votim.

Me votimin e këtij projektligji e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Mbledhja e radhës dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit edhe një herë, zonja zëvendësministre dhe stafi që ju shoqëron!

Ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**